



Në bazë të nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010) Kryetari i Komunës së Gostivarit publikon:

LISTËN E INFORMATAVE ME KARAKTER PUBLIK

❖ Komuna si e pavarur, në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin dhe ligjet e veçanta, i kryen punët në interes publik me rëndësi lokale si dhe punët që nuk janë përjashtuar nga kompetenca e saj ose nuk janë në kompetencë të organeve të pushtetit shtetëror.

• Komuna është kompetente për kryerjen e punëve vijuese:

- Planifikimi urbanistik (urban dhe rural), dhënia e lejeve për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale të përcaktuara me Ligj, rregullimi i hapësirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore;
- Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës në kuptim të ndërmarrjes së masave për mbrojtjen dhe pengimin e ndotjes së ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurma dhe rrezatimi i pajonizuar;
- Zhvillimi ekonomik lokal në kuptim të planifikimit të zhvillimit ekonomik lokal, përcaktimi i prioriteteve zhvillimore dhe strukturale, udhëheqja e politikës lokale ekonomike, përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të sipërmarrësve në nivel lokal dhe në këtë kontekst pjesëmarrja në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal të institucioneve dhe agjencive dhe promovimi i partneritetit;
- Veprimtaritë komunale në kuptim të furnizimit me ujë për pije, dërgimi i ujit teknologjik, dërgimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura, dërgimi dhe trajtimi i ujërave atmosferike, ndriçimi publik, mirëmbajtja e pastërtisë publike, grumbullimi, transportimi dhe veprimi me hedhurina komunale të ngurta dhe teknologjike, rregullimi dhe organizimi i transportit lokal dhe publik të udhëtarëve, mirëmbajtja e varreve, varrezave dhe dhënia e shërbimeve funerale, ndërtimi, mirëmbajtja, rikonstruimi dhe mbrojtja e rrugëve dhe rrugicave lokale dhe objekteve tjera të infrastrukturës, rregullimi i rregjimit të komunikacionit, ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit rrugor

për komunikacion, ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirës publike për parkim, largimi i makinave të parkuara gabimisht, largimi nga sipërfaqet publike të automjeteve të shkatërruara, ndërtimi dhe mirëmbajtja e tregjeve, pastrimi i oxhaqeve, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, gjelbërimit, park-pyjeve dhe sipërfaqeve rekreative, rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i shtretërve të lumenjëve në pjesët e urbanizuara, përcaktimi i emrave të rrugëve, shesheve dhe objeteve tjera të infrastrukturës;

- Kultura, në kuptim të përkrahjes institucionale dhe financiare të enteve kulturore dhe projekteve të kulturës, kultivimi i folklorit, dokeve, zanateve të vjetra dhe vlerave të ngjajshme kulturore, organizimii i manifestimeve kulturore, nxitja e specifikave dhe formave të ndryshme të krijimtarisë;

- Sport dhe rekreim në kuptim të zhvillimit të sportit masovik dhe aktiviteteve rekreative, organizimi i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive, mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve për sport si dhe mbështetja e lidhjeve sportive;

- Mbrojtja sociale dhe e fëmijëve në kuptim të financimit, investimeve, mirëmbajtjes dhe pronës së çerdheve për fëmijë dhe shtëpive për pleq, realizimi i përkujdesjes sociale për persona invalid, fëmijë pa prindër dhe përkujdesje prindore, fëmijë me problem edukativo-sociale, fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë të familjeve me një prind si dhe fëmijë nga rruga, persona të ekspozuar rrezikut social, të përfshirë në keqpërdorimin e drogës dhe të alkoolit, ngritja e vetëdijes së popullatës, strehimi i personave të rrezikuar social, realizimi i të drejtës dhe të edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore;

- Arsimi në kuptim të themelimit, finansimit dhe administrimit të shkollave fillore dhe të mesme në bashkëpunim me pushtetin qendror, në pajtim me ligj si dhe organizimi i transportit dhe të ushqyerit e nxënësve dhe vendosja e tyre nëpër shtëpi nxënësish;

- Mbrojtja shëndetësore në kuptim të drejtimit me rrjetin e objekteve publike dhe organizatave shëndetsore publike të mbrojtjes parësore shëndetësore, në të cilat komuna është e përfaqësuar në të gjitha këshillat e të gjitha organizatave shëndetsore në pronësi publike, edukimi shëndetësor, përparimi i shëndetit, aktiviteteve preventive, mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtjes gjatë punës, mbikëqyrja shëndetsore e ambientit jetësor, mbikëqyrja e sëmundjeve ngjitëse, ndihmë pacientëve me nevoja speciale dhe lëmive tjera të përcaktuara me ligj;

- Realizimi i përgatitjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërimet luftarake, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe nga pasojat e shkaktuara prej tyre;

- Mbrojtja kundër zjarrit e kryer nga ana e njësisë territoriale të zjarrfikësve.

- Mbikëqyrja ndaj kryerjes së punëve në kompetencë të komunës;

- Punë të tjera të përcaktuara me ligj.

- Kompetencat e lartpërmendura realizohen në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara me ligj, të rregulluara me dispozita të Këshillit dhe akte të Kryetarit të Komunës, në pajtim me ligj.

❖ **Organet e komunës janë: Këshilli dhe Kryetari i komunës.**

1.Këshilli i Komunës

Këshilli i komunës i kryen punët vijuese:

- Sjell Statutin e Komunës;
- Sjell Rregulloren për punë të Këshillit;
- Sjell Programin e vet të punës;
- Sjell Buxhetin e Komunës dhe Llogarinë vjetore të Komunës;
- E përcakton lartësinë e shkallëve të tatimit dhe lartësinë e kompensimeve dhe taksave;
- Sjell Planin gjeneral urbanistik;
- Sjell planet detaje urbanistike dhe dokumentacion urbanistik për vendbanim në komunë;
- Sjell Program për rregullimin e tokës ndërtimore;
- Sjell Program për mirëmbajtjen e sinjalizimit të komunikacionit;
- Sjell Vendim për rregullimin e regjimit të komunikacionit;
- Sjell dispozita nga lëmia e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës, zhvillimit ekonomik lokal, kulturës, sportit dhe rekreacionit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes kundër zjarreve në kornizat e kompetencave të përcaktuara me Ligj të veantë ose në pajtim me programin nacional;
- Sjell Program për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe rrugicave lokale;
- Sjell Program për ndriçim publik;
- Sjell Program për ndërtim, rikonstruim dhe mirëmbajtje të ujësjellësve lokal;
- Sjell Program për mirëmbajtjen e pastërtisë publike;
- Sjell Program për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e parqeve dhe sipërfaqeve tjera publike me rëndësi lokale;
- Sjell Program për mirëmbajtjen e varrezave;
- Sjell Program për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e lumenjëve në rajonet e urbanizuara;
- Sjell Vendim për pastërti publike;
- Sjell Vendim për mënyrën e transportit në komunikacionin urban dhe ndërurban;
- Sjell Vendim për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tregjeve publike;
- Sjell Vendim për mënyrën e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjen e varrezave;
- E rregullon mënyrën e pastrimit të oxhaqeve;
- E rregullon mirëmbajtjen e hapësirës publike për parkimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të saj;
- Përcakton emra të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës me rëndësi lokale;
- Sjell Vendim organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale me propozim të Kryetarit të Komunës;
- Themelon shërbime publike dhe bën mbikëqyrjen e punës së tyre;
- Emëron anëtarë në këshillat drejtues të shërbimeve publike që i themelon;

- Miraton programe pune dhe plane financiare për financimin e shërbimeve publike të cilët i themelon;
- Vendos për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarisë me interes publik me rëndësi lokale në pajtim me ligj;
- I miraton raportet e punës dhe llogaritë vjetore të shërbimeve publike që i themelon;
- Vendos për mënyrën e disponimit me pronën e Komunës;
- Vendos për mënyrën e kryerjes së kontrollimit financiar të buxhetit të Komunës, në pajtim me ligj;
- E zgjedh personin i cili udhëheq me njësinë rajonale të Ministrisë për Punë të Brendshme në Komunë në pajtim me ligj;
- E shqyrton dhe miraton raportin vjetor për siguri publike në territorin e Komunës që ia dorëzon Ministrisë për Punë të Brendshme dhe Avokatit Popullor;
- Mund t'i jep rekomandime personit udhëheqës të njësisë rajonale të Ministrisë për Punë të Brendshme nga lëmia e sigurimit publik dhe sigurimit në komunikacion;
- Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Këshillit;
- Formon komisione të përhershme dhe të përkohshme dhe trupa të posaçme të komunës;
- Ushtron autorizime të veçanta në pajtim me ligj ndaj të mirave në përdorimim të përgjithshëm dhe ndaj pasurive natyrore në rajonin e Komunës;
- Përcakton mirënjohje dhe shpërblime komunale;
- Jep mendim për propozim-ligjet që kanë të bëjnë me komunën;
- Bën zgjedhje tjera dhe emërime nga kompetencat e tij;
- Sjell Vendime tjera për punët nga kompetenca e tij;
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me ligj.

- **Seancat e Këshillit të komunës janë publike**

Këshilli mund të punojë pa praninë e opinionit vetëm në raste të caktuara me ligj si dhe kur atë do ta propozojnë Kryetari i Komunës, Kryetari i Këshillit ose më së paku 3 (tre) anëtarë të Këshillit.

Përjashtimi i opinionit mund të kërkohet, kur çështja për të cilën diskutohet, ka pika të përbashkët me moralin publik; kur mund t'i rrezikojë interesat e një personi të caktuar apo të ketë pika takuese me mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve.

Për përjashtimin e prezencës së publikut nga seanca Këshilli vendos pa debat, me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Gjatë debatit për buxhetin e komunës, llogarinë përfundimtare dhe për planet urbanistike, prania e publikut nuk mund të përjashtohet.

2.Kryetari i Komunës

Kryetari i Komunës i kryen punët vijuese:

- E prezenton dhe e përfaqëson Komunën;

- E kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të Këshillit;
- I publikon dispozitat e Këshillit në buletin zyrtar të Komunës;
- E siguron ekzekutimin e vendimeve të Këshillit;
- E siguron ekzekutimin e punëve që me ligj i janë deleguar Komunës;
- Inicon dhe propozon sjelljen e dispozitave nga kompetenca e Këshillit;
- E propozon buxhetin vjetor dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit të Komunës;
- E ekzekuton buxhetin e Komunës;
- Zgjedh drejtorët e shërbimeve publike që i ka themeluar Komuna në bazë të shpalljes publike;
- Rregullisht e njofton Këshillin për realizimin e kompetencave të veta në pajtim me Statutin;
- Vendos në procedurë administrative për të drejta, obligime dhe interesa të personave juridik dhe fizik në pajtim me ligj;
- E sjell Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale;
- Udhëheq me administratën komunale;
- Vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën komunale, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj;
- Siguron shfrytëzim ligjor dhe mbrojtjen e pronës së Komunës në pajtim me ligj dhe me Statut;
- Mundet të autorizojë nëpunës udhëheqës të komunës që të zhvillojë procedurë dhe të vendos në çështje administrative, si dhe të nënshkruajë akte;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me Statut, merr pjesë në punën e seancave të Këshillit kurse sipas nevojës edhe në seancat e komisioneve të Këshillit dhe të trupave të posaçëme të komunës, pa të drejtë vendosjeje.

3.Administrata komunale

Administrata komunale i kryen punët në vijim:

- Përgatit aktet për Këshillin dhe për Kryetarin e Komunës;
- Përgatit seancat e Këshillit, si dhe seancat e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme të tij;
- Kryen punë profesionale për Këshillin dhe për Kryetarin e Komunës;
- E organizon dhe realizon punën financiare të komunës;
- Përcjell problematikën nga fushat në kompetencë së komunës, bën analizë të gjendjes dhe jep iniciativa dhe propozime për zgjidhjen e tyre;
- Dorëzon informata dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e komunës me kërkesë të organeve kompetente ose në bazë të ligjit;
- Administron me dokumentet e komunës dhe i ruan deri në asgjësimin e tyre, përkatësisht dorëzimin e tyre deri te Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë dhe
- Kryen edhe punë të tjera që do t'i përcaktojë Këshilli dhe Kryetari i komunës.

❖ Administrata komunale e Komunës së Gostivarit në pajtim me Vendimin për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale të Komunës së Gostivarit nr.08-1524/1 të sjellur nga Këshilli i Komunës së Gostivarit në mbledhjen e 20-të të mbajtur më 15.06.2015, është e organizuar në sektorët dhe departamentet si në vijim:

1.Sektori për përkrahjen e Kryetarit të komunës, në përbërjen e të cilit janë këto departamente:

- 1.1. Departamenti për koordinimin e aktiviteteve të Kryetarit të komunës, informim dhe marrëdhënie me publikun;
- 1.2. Departamenti për zhvillim ekonomik lokal;

2.Sektori për punë juridike, të përgjithshme dhe organizative, në përbërjen e të cilit janë këto departamente:

- 2.1. Departamenti për punë normative – juridike;
- 2.2. Departamenti për përkrahjen e Këshillit të komunës;
- 2.3. Departamenti për përkrahje informatike dhe punë të përgjithshme;

3.Sektori për çështje financiare, në përbërjen e të cilit janë këto departamente:

- 3.1. Departamenti për koordinimin e buxhetit dhe kontrollin e buxhetit;
- 3.2. Departamenti për kontabilitet dhe pagesa;
- 3.3. Departamenti për tatime, taksa, kompensime dhe të hyra të tjera të komunës;
- 3.4. Departamenti për furnizime publike;

4.Sektori për urbanizëm, komunikacion, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor, në përbërjen e të cilit janë këto departamente:

- 4.1. Departamenti për urbanizëm, ndërtimtari, planifikim hapsinor dhe rregullimin e tokës ndërtimore;
- 4.2. Departamenti për planifikimin dhe zhvillimin e komunikacionit, në rajonin e komunës;
- 4.3. Departamenti për veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor;

5.Sektori për veprimtari publike, në përbërjen e të cilit janë këto departamente:

- 5.1. Departamenti për arsim, sport dhe kulturë;
- 5.2. Departamenti për mbrojtje shëndetësore, sociale dhe të fëmijëve dhe mbrojtje dhe shpëtim;

6.Sektori për mbikqyrje inspektuese, në përbërjen e të cilit janë këto departamente:

- 6.1. Departamenti për inpeksion komunal, inpeksion për mjedis jetësor dhe inpeksion ndërtimor;
- 6.2. Departamenti për lloj tjetër të mbikqyrjes inspektuese nga kompetenca e komunës;

7. Departamenti për revizion të brendshëm

8. Departamenti për menaxhim me resurse njerëzore

9. Njësia territoriale kundër zjarrit e Komunës së Gostivarit

❖ Qasja e lirë në informata me karakter publik

“Informatë me karakter publik” është informata që në cilën do formë e ka krijuar ose me të cilën disponon Komuna.

Qasje të lirë në informata me karakter publik kanë të gjithë personat fizik dhe juridik.

Qasje të lirë në informata kanë edhe personat fizik dhe juridik të huaj në pajtim me ligj. Komuna si posedues i informatave e siguron të drejtën e qasjes së lirë në informatat me karakter publik me të cilat posedojnë organet e Komunës (Këshilli dhe Kryetari i Komunës), në pajtim me ligj.

Me përjashtim në raste të përcaktuara me ligj, e drejta e qasjes së lirë në disa informata, mund të jetë e kufizuar ose sigurohet qasje e pjesëshme.

Procedura për realizimin e të drejtës së qasjes së lirë në informatat realizohet në pajtueshmëri me ligjin.

Kërkuesi qasjen në informatë mund t`a bëjë me gojë, me shkrim ose në formë elektronike.

Kryetari i Komunës krijon kushte dhe ndërmerr masat e parapara me ligj, për realizimin e të drejtës së qasjes së lirë në informatat me karakter publik.

Nëse Komuna si posedues i informatave nuk disponon me informatën e kërkuar sipas procedurës së përcaktuar me ligj, është e obliguar t`a përcjellë kërkesën deri te poseduesi i informatës i cili sipas përmbajtjes së kërkesës është posedues i informatës, nëse me saktësi e din se kush është posedues dhe për atë do t`a informojë kërkuesin.

Nëse nuk e dihet me saktësi se kush është poseduesi i informatës dhe nuk është në gjendje t`a përcjellë kërkesën, për atë do t`a informojë kërkuesin.

Kërkuesi i informatës me karakter publik ka të drejtë në mbrojtje juridike të realizuar në procedurë, të përcaktuar me ligj.

**Kryetari i Komunës së Gostivarit
Nevzat Bejta**